

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit Gëzim LLulluni dhe Nora Bllaca Dula, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.P. nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.A. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Astrit Hoti, për kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesave të paraqitura nga i autorizuari i paditësit dhe i autorizuari i të paditurës të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.442/08, i datës 09.01.2013, në seancën jo publike të mbajtur me datë 21.02.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Pranohet pjesërisht ankesa e të autorizuarit të paditësit N.P., nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.442/08, i datës 09.01.2013, në pjesën e kërkesëpadisë lidhur me shpenzimet e vizitave nga familjarët e paditësit, ashtu që vendoset, DETYROHET e paditura Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit për vizitat e familjarëve t'i paguaj shumën prej 925 Euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar për këtë kërkesë refuzohet e pabazuar.

II. Pranohet pjesërisht ankesa e të autorizuarit të të paditurës Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.442/08, i datës 09.01.2013, në pikën II (dy) të dispozitivit pika II.1 (dy pik një) dhe II.2 (dy pikë dy) lidhur me kërkesëpadinë për vuajtje psikike, shkelje e dinjitetit dhe lirisë, ashtu që vendoset, DETYROHET e paditura Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit për shkak të vuajtjeve psikike për shkak të shkeljes së dinjitetit dhe lirisë t'i paguaj shumën prej 26.300 Euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për vuajtje psikike, shkelje të dinjitetit dhe lirisë refuzohet e pabazuar.

III. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditurës Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.442/08, i datës 09.01.2013, në pikën III (tre) të dispozitivit lidhur me kompensimin në emër të fitimit të humbur, dhe për shpenzimet të procedurës (*pika IV e shënuar si gabim teknik sepse duhet të jetë pika V*) VËRTETOHET.

IV. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit N.P., nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.442/08, i datës 09.01.2013, në pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë për kompensimin në emër të vuajtjeve psikike, në emër të shkeljes së dinjitetit dhe në emër të kamatës për fitimin e munguar VËRTETOHET.

V. Pranohet pjesërisht ankesa e të autorizuarit të paditurës Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.442/08, i datës 09.01.2013, përkitazi me kamatën dhe vendoset ashtu që DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguajnë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 09.01.2013, e deri në pagesën definitive

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.442/08, i datës 09.01.2013, në pikën I (një) e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.P. nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut.

Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, që paditësit N.P. nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, në emër të kompensimit të dëmit jo material, t'ia paguaj shumën e mjeteve prej 35.000,00 Euro, me normën e kamatës, në lartësi prej 3.5%, e cila do të llogaritet nga data e ekspertizës 15.11.2012, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe atë sikurse vijon: II. 1. Në emër të vuajtjeve psikike, shumën e mjeteve në lartësi prej 25.000,00 Euro, II.2. Në emër të shkeljes së dinjitetit dhe lirisë shumën e mjeteve në lartësi prej 10.000,00 Euro.

Në pikën III (tre) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditësit në emër të dëmit material për fitimin e humbur, për periudhën sa ka qenë i privuar pa të drejtë nga liria nga data 27.10.2003, deri me datë 06.04.2005, t'ia paguaj shumën e mjeteve prej 5.646,30 Euro, me normën e kamatës, në lartësi prej 3.5% e cila do të llogaritet nga data e ekspertizës financiare e datës 26.12.2012, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në pikën IV (katër) të dispozitivit e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit N.P. nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, mbi shumat e gjykuara dhe atë në emër të vuajtjeve psikike në shumë prej 105.000,00 Euro, në emër të shkeljes së dinjitetit në shumë prej 40.000,00 Euro, në emër të kamatës për fitimin e humbur në shumë prej 1.014,70 Euro, në emër të shpenzimeve të vizitave nga familjarët në shumë prej 7.200,00 Euro, në emër të paketave në shumë prej 5.000,00 Euro, në shumë të përgjithshme prej 158.214,70 Euro, si kërkesë e pabazuar në ligj.

Në pikën V (pesë) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.095,40 Euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit dhe i autorizuari i të paditurës.

I autorizuari i paditësit e ka atakuar aktgjykimin për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit mbi lartësinë e shumës së përcaktuar për dëmin material dhe jo material, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar ndërsa aktgjykimin e atakuar t'a ndryshojë dhe ta aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadia e paditësit.

I autorizuari i të paditurës e ka atakuar aktgjykimin për shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar në pjesën aprovuese të ndryshohet ashtu që paditësit t'i aprovohen shumat e cekura sipas kriterit të përcaktuar nga Departamenti Administrativ i Drejtësisë (Departamenti i Administratës Gjyqësore), ose aktgjykimi në këtë pjesë të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të paditësit dhe ankesa e të autorizuarit të paditurës janë pjesërisht të bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi N.P. nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit material dhe jo material në gjykatën e shkallës së parë kundër të paditurit Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material për shkak të privimit pa të drejtë nga liria t'ia paguajë shumën prej 207.200,00 Euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 3.5% të llogaritura nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata duke vepruar sipas padisë ka caktuar shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit të provave ka marrë aktgjykimin e atakuar C.nr.442/08, i datës 09.01.2013, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata ka theksuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësi padrejtësisht, është privuar nga liria, po ashtu as fakti se paditësi padrejtësisht është ngarkuar me veprën penale krime lufte, nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësit i takon e drejta në kompensimin e dëmit dhe se ajo është përgjegjësi e të paditurës pasi që në procedurë jashtë gjyqësore e paditura ka ofruar marrëveshjen për kompensimin e dëmit, mirëpo ka konstatuar se kontestuese është fakti sa i përket lartësisë së kompensimit të dëmit.

Më tej ka theksuar se në rastin konkret paditësi ka përjetuar vuajtje psikike dhe shkelje të dinjitetit për shkak të privimit pa të drejtë nga liria nga data 27.10.2003, e deri me datë 06.04.2005, dhe përballje pa të drejtë me procedurën gjyqësore me qëllim të vërtetimit të pafajësisë së tij që nga koha kur është paraburgosur e deri sa vendimi ka marrë formën e prerë me datë 25.01.2008.

Paditësi kishte përjetuar vuajtje shpirtërore të cilat ishin manifestuar në forma të ndryshme të rënda gjatë tërë kësaj periudhe kur ishte gjykuar për veprën penale krime lufte ndaj popullsisë civile. Në këtë kontekst vuajtjet shpirtërore dhe shkelja e dinjitetit janë manifestuar si pasojë e procedurës penale të udhëhequr ndaj tij dhe faktit se paditësi gjatë tërë kësaj periudhe është munduar të dëshmoj pafajësinë e tij dhe të bindë gjykatën, rrethin në të cilin ka jetuar si dhe familjen e tij për shkak të ngarkimit të pa të drejtë që ishte bërë ndaj tij. Paditësi si mjek veterinar ka realizuar të ardhura duke ushtruar profesionin e tij me të cilat ka mbajtur veten dhe familjen e tij derisa gjatë ballafaqimit me këtë procedurë gjyqësore penale të njëjtit i janë shkaktuar dëmit material për shkak të humbjes së fitimit të cilën e realizonte me punën e tij, andaj e paditura është përgjegjëse për dëmin i cili i është shkaktuar paditësit sepse përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit rrjedh nga rregullat e përgjegjësive juridik-civile dhe penalo-juridike.

Lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë dhe natyrën e lëndimeve gjykata e shkallës së parë i është referuar mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjekësor nga lëmia e psikiatrisë Dr. F.D., të dhënë në procesverbalin e datës 15.11.2012, si dhe në procesverbalin e datës 18.12.2012, në bazë të ekzaminimit të drejtpërdrejtë psikiatrik në seancë (*intervista psikiatrike, konsolidimi i ngjarjeve emocionale, shpirtërore, materiale*), ka konstatuar se paditësi N.P. ka përjetuar vuajtje shpirtërore e cila është manifestuar në formë të ankthit, në formë të depresionit, mërzitjes, shqetësimeve psikike të formave të ndryshme, ku ky dezekuilibrim psikosocial me intensiv ka qenë në fazat e para kohore të procesit gjyqësor. Ka shtuar se vuajtja shpirtërore e cila është manifestuar me intensitet të lartë ka qenë në periudhën dy mujore, vuajtje shpirtërore me intensitet të mesëm ka qenë në kohëzgjatje prej dy muaj, si dhe me vuajtje shpirtërore me intensitet të ulët gjatë tërë kohës, andaj edhe ka vendosur që pjesërisht ta aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Lidhur me mënyrën e vendosjes si në pikën III të dispozitivit që ka të bëjë me kompensimin e dëmit material për fitimin e humbur, gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka mbështetur në mendimin dhe konstatimin të ekspertit financiar-aktuarit Aziz Berisha dhënë në ekspertizën e datës 26.12.2012, sipas të cilit paditësi si pasojë e privimit padrejhtësisht nga liria gjatë periudhës 27.10.2003, e deri me 06.04.2005, duhet t'i kompensohet dëmi material në emër të fitimit të humbur shumën prej 5.646.30 Euro.

Lidhur me mënyrën e vendosjes si në pikën IV të dispozitivit që ka të bëjë pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë për dëmin jo material, gjykata ka arsyetuar se një kërkesë e tillë nuk është ekuivalente me vuajtjet shpirtërore dhe shkallën e shkeljes së dinjitetit që ka përjetuar paditësi dhe se çdo shumë e gjykuar më lartë se shumata e gjykuara në këtë aktgjykim nuk do të kishte për qëllim satisfaksionin por do të përbënte përfitim pasuror, ku ligji ka përcaktuar se qëllimi i kompensimit të dëmit nuk është përfitim pasuror por satisfaksioni ka për qëllim që ta kompensojë të dëmtuarin për shkak të vuajtjeve shpirtërore përkatësisht ç'rregullimit psiko-fizik që është shkaktuar si pasojë e veprimit të paditurës, ndërsa sa i përket pjesës refuzuese për kompensimin e dëmit material dhe atë shumën prej 1.015,00 Euro, në emër të kamatës për fitimin e humbur prej datës 12.03.2008, e deri me 31.12.2012, gjykata ka refuzuar këtë shumë meqenëse detyrimi për kamatë fillon të rrjedh nga koha kur gjykata dhe palët janë në dijeni për lartësinë e dëmit dhe në këtë rast është data e ekspertizës.

Kurse lidhur pjesën tjetër të kërkesave në emër të vizitave nga familjarët në shumë prej 7.200 Euro dhe në emër të paketave shumë prej 5.000 Euro, gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar këtë pjesë të kërkesës për faktin se paditësi me asnjë provë të vetme nuk ka arritur ta provojë pretendimet e tij.

Për bazë i është referuar nenit 8, 323, 319 pika 1, dhe 452 pika 1, të LPK-së, si dhe nenit 154, 198 dhe 200 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë nga ana e të paditurës për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së. Nuk mund të pranohet pretendimi për këtë shkelje sepse pjesa e ndryshuar e aktgjykimit ka të bëjë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale e jo me arsyetimin e gabuar. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale e ka paracaktuar edhe arsyetimin e aktgjykimit për secilën kategori të dëmit. Aktgjykimi nuk është i përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Nga ana e palës paditëse nuk janë paraqitur pretendime për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.

Lidhur me gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht për pretendimet e paraqitura me të dy ankesat për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë për shkak se gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë kontekst është pranuar në tërësi gjendja e konstatuar nga ajo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se paditësi ishte gjykuar për krime lufte nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.215/04, të datës 12.05.2005, dhe ishte liruar nga akuza, mirëpo kishte qëndruar në paraburgim në kohëzgjatje prej 526 ditësh, pra deri kur i është zëvendësuar masa e paraburgimit me një masë tjetër.

Me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AP-KZ 477/05, të datës 25.01.2008, kjo gjykatë konstaton se gjykata e shkallës së dytë penale e ka vërtetuar pafajësinë e paditësi dhe rrjedhimisht ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin paditësi ishte liruar nga akuza.

Për dëmin material që ka pësuar paditësi lidhur me fitimin e munguar gjykata në cilësinë e provës ka nxjerr ekspertizën financiare të punuar nga aktuari Aziz Berisha, me datën 26.12.2012, me të cilën ka konstatuar se duke e marrë parasysh faktin se paditësi me profesion është mjek veteriner dhe të ardhurat mesatare me përgatitje të tillë janë 325.85 Euro në muaj, ndërsa në total për tërë periudhën e qëndrimit në paraburgim nga data 27 tetor 2003 deri me 06 prill 2005, janë në total prej 5.646 Euro.

Për dëmin jo material gjykata ka bërë marrjen e provës me ekspertizë mjekësore të punuar nga eksperti i lëmisë së psikiatrisë Dr. F.D., në seancën e datës 15.11.2012, nga ka rezultuar se paditësi ka përjetuar vuajtje shpirtërore e manifestuar në formë të ankthit, depresionit, mërzitjes, shqetësimeve psikike të formave të ndryshme. Konstatimet e ekspertit me përmbajtje si në pjesën përshkruese të këtij arsyetimi përkitazi me konstatimet e gjykatës së shkallës së parë.

Gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe të plotë Gjkata e Apelit, andaj mbi këtë gjendje faktike është bërë edhe ndryshimi i një pjesë të vendosjes për kërkesëpadinë e paditësit.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar Gjkata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Gjkata e Apelit ka vendosur si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi pasi që ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale lidhur me kërkesën për kompensimin e shpenzimeve për vizita familjare nga të afërmit e paditësit gjatë kohës së qëndrimit të tij në paraburgim. Në mungesë të të dhënave të plota për vlerën e shpenzimeve për vizitat e bëra dhe pakot e dërguara nga familjarët e paditësit, Gjkata e Apeli vlerëson se gjykata e shkallës së parë është dashtë të marrë për bazë vendimin e Këshillit Gjyqësor-Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor mbi Kriteret e Përgjithshme për Kompensimin e Dëmit të Personave të Dënuar ose të Arrestuar pa Arsye, i datës 3 korrik 2007. Sipas këtij vendimi në nenin 4 të të njëjtit përcaktohet se: *“Kompensimi për shpenzimet e anëtarëve të familjes për vizitat e bëra personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye, dërgimit të pakove dhe bartjen e shpenzimeve tjera të transportit për anëtarët e familjes, u takon shuma prej 25 Euro për një vizitë, përkatësisht 50 Euro, maksimalisht për dy vizita mujore”*. Në kontekstin e kësaj dispozite rezulton se vetë e paditura e ka përcaktuar vlerën e kompensimit për një të drejtë që u takon personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye. Pra e paditura ka përcaktuar standardin minimal të kompensimit për situatën kur çështja trajtohet në procedurë jashtëgjyqësore.

Në këtë rast duke marrë në konsideratë faktin se paditësi nuk ka arritë të provoi para gjykatës së lartësia e kompensimit është ajo e pretenduar, atëherë gjykata është dashtë që ta aplikoj kompensimin e përcaktuar me vendimin në fjalë.

Në rastin konkret paditësi ka qëndruar në paraburgim 526 ditë, përndryshe 75 javë dhe nëse llogaritë vizita çdo dy javë, na rezulton se gjatë asaj periudhe nga familjarët ka pasur 37 vizita. Kur llogaritë çdo vizitë në shumë prej 25 Euro ashtu siç është paraparë me vendimin e të paditurës na rezulton se totali i kompensimit është 925 Euro. Kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të vizitave të realizuara nga familjarët e paditësit gjen mbështetje në dispozitat e nenit 185 të LMD-së.

Për pjesën e refuzuar të kërkesës për këtë kategori të dëmit Gjykata e Apelit vendosi duke e pas parasysh faktin se paditësi nuk ka arritur të provoi lartësinë përtej asaj që gjykata vendosi sipas vendimit të të paditurës.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën II (dy) të dispozitivit të këtij aktgjykimi pasi që vlerësoj se gjendja faktike lidhur me këtë kategori të dëmit është konstatuar drejtë dhe plotësisht. Në këtë rast nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka qëndruar në paraburgim në kohëzgjatje prej 526 ditësh pa të drejtë. Gjykata e shkallës së parë ka bërë edhe marrjen e provës me ekspertizë të psikiatrisë për të konstatuar dhimbjet shpirtërore të paditësit gjatë qëndrimit në paraburgim, por sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit një ekspertizë e tillë duhet të shikohet në kontekstin e rrethanave të caktuara që kanë ndikuar në shkaktimin e dhimbjeve shpirtërore-vuajtje psikike nga shkaku se janë pikërisht rrethanat e caktuara të cilat gjykata duhet ti vlerësojë me rastin e caktimit të kompensimit për këtë kategori të dëmit qoftë edhe pa marrjen e provës me ekspertizë.

Me dispozitën e nenit 200 paragrafi 1 të LMD-së, është përcaktuar se: *„Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material“*, ndërsa në pragrafin 2 të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror“*. Nga interpretimi i paragrafit 1 të nenit 200 të LMD-së, rezulton për dhimbjet e pësuar shpirtërore do të gjykohet kompensimi, por në çdo rast dhimbjet shpirtërore duhet të jenë pasojë e një rrethane që e shkakton dhimbjen siç mund të jetë shkelje e nderit, e lirisë, e vdekjes së të afermit, etj. Pra nuk mund të gjykohet kompensimi për dhimbje shpirtërore-vuajtje psikike pa qenë dhimbje shpirtërore-vuajtje psikike e ndërlidhur me një rrethanë që e shkakton dhimbjen. Në këtë kontekst Gjykata e Apelit e gjen të zbatuar gabimisht nga gjykata e shkallës së parë dispozitën e nenit 200 të LMD-së, për dhimbjet shpirtërore-vuajtje psikike sepse e ka gjykuar dhimbjen shpirtërore sikur të përfaqësonte e njëjta dy kategori të dëmit jomaterial.

Në rastin konkret në kontekstin e dispozitës së cituar nga paragrafi 1, i nenit 200 të LMD-së, paditësi i takon kompensimi për dhimbje shpirtërore-vuajtjet psikike (*vuajtjet psikike në literaturë përdoren si perjetim analog i dhimbjeve shpirtërore që i korrespondon dispozitës së dicuar*) për shkak të shkeljes së nderit ose të lirisë.

Po të vlerësonte gjykata dhe po të kishte kërkesë edhe mund të gjykonte ndaras kërkesën për cenim shkeljes së nderit dhe po ashtu ndaras kërkesën për cenim të lirisë, por kurrësi nuk mund të qëndroj si e veçantë kërkesa për dhimbje shpirtërore pa u ndërlidh me ndonjerën nga rrethanat që e shkakton dhimbjen shpirtërore e cila gjithashtu duhet të jetë e përcaktuar apo përmbajtje e dispozitës ligjore e cila e parasheh mbrojtjen e të drejtës subjektive.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar edhe rrethanat e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 200 të LMD-së, vlerësojë se shumica e gjykuar si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi në emër të kompensimit për dhimbjet shpirtërore për shkak të shkeljes së dinjitetit dhe lirisë është në proporcion me të mirën e shkelur dhe me qëllimin e kompensimit për dëmin jo material. Gjykata vlerësojë posaçërisht rrethanat se natyra e veprës për të cilën ishte akuzuar paditësi ishte e rëndë-për krime të luftës dhe rrjedhimisht dhimbjet shpirtërore për shkak të akuzës kanë qenë të mëdha ashtu siç edhe eksperti ka konstatuar me ekspertizë. Përveç dhimbjeve shpirtërore që ka shkaktuar natyra e veprës për të cilën është akuzuar paditësi në shkallën e dhimbjeve gjykata ka vlerësuar se ka ndikuar edhe kufizimi i lirë në këtë rast si i paraburgosur për një periudhë relativisht të gjatë prej 526 ditësh dhe kur këto dy rrethana janë bashkuar sigurisht që tek paditësi kanë ndikuar në intezitetin e dhimbjeve. Megjithatë Gjykata e Apelit rithekson se kompensimi i dëmi jo material në vetvete ka një qëllim që është satisfaksioni për të dëmtuarin. Në këtë kontekst kjo gjykatë vlerëson se shpërblimi i dëmit në këtë rast është caktuar në kuptimin që të jetë i drejtë dhe adekuat me vëllimin e dëmit që ka pësuar paditësi. Kjo nënkupton se lartësia e kompensimit jepet si satisfaksion dhe motivohet nga qëllimi që t'i mundësojë paditësit satisfaksion-kënaqje të caktuar për vlerën e dëmit jo material. Gjykata kur ka vendosur për vlerën e kompensimit ka marrë parasysh rrethanat që kanë ndikuar në shkallë e të drejtave të cenuar pasojë e procedurës penale siç janë kohëzgjatja e qëndrimit në paraburgim, natyra e veprës për të cilën është akuzuar, moshën e të dëmtuarit, profesionin e tij dhe rrethanat familjare e shoqërore.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë si në pikën dy të dispozitivit të aktgjykimit kjo gjykatë vlerësojë se lartësia e kërkuar nuk është në harmoni me të mirën e shkelur dhe rrjedhimisht as me qëllimin për të cilin gjykohej kompensimi.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën III (tre) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, përkitazi me dëmin material në këtë rast për fitimin e humbur duke e vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë sepse kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka aplikuar të drejtën materiale. Në këtë rast përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me dispozitat e nenit 188 të LMD-së, ndërsa lartësia e kërkesës është vërtetuar me anë të ekspertizës financiare e cila është punuar me metoda shkencore dhe ashtë argumentuar mjaftueshëm për t'u vlerësuar si profesionale dhe e besueshme. Nuk janë pranuar pretendimet për lartësinë e kërkesëpadisë sepse me ekspertizë është vlerësuar kompensimi sipas profesionit që ka paditësi dhe në këtë kontekst shumica e gjykuar është e drejtë. Në pikën tre të dispozitivit të këtij aktgjykimi është vërtetuar edhe pjesa e vendimit për shpenzimet e procedurës për çka kjo gjykatë thekson se vendimi mbi shpenzimet është në harmoni me dispozitat e LPK-së, me veprimet e ndërmarra dhe numrin e përfaqësimeve dhe në harmoni me tarifën e përfaqësimeve dhe shpenzimeve tjera për ekspertizë dhe taksa gjyqësore.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën IV (katër) të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e vlerësuar si të drejtë dhe të rregullt vendimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën e refuzuar të tij për shkak se pjesa e refuzuar e kërkesëpadisë për dëmin jo material është përfundimi i drejtë. Edhe Gjykata e Apelit ka vlerësuar se kërkesëpadia ishte shumë e lartë dhe në shpërputhje me natyrën e dëmeve që i ishin bërë paditësit, e gjithashtu në shpërputhje edhe me qëllimin e kompensimit për dëmin jo material.

Sa i përket pjesës së refuzuar të kërkesëpadisë për dëmin material kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë nga shkakut se për tërësinë e kërkesës është gjykuar kamata dhe gjithashtu duhet të merret në konsideratë edhe arritshmëria e kërkesave dhe momenti i kërimit të mbrojtjes gjyqësore.

Aktgjykimi është ndryshuar edhe sa i përket kamatës sepse gabimisht ishte aplikuar e drejta materiale, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e duke iu referuar nenit 277 të LMD-së. Si datë të rrjedhjes së kamatës është përcaktuar data e nxjerrjes së ekspertizës.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 200 dhe 201 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.854/13, me datë 21.02.2018

Kryetari i kolegjit
Albert Zogaj, d.v